



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 10.12.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e programit të vlerësimeve etike dhe profesionale për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 15. Erion Fejzulla, USAID.*
- 16. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 17. Eris Milova, KSHH.*
- 18. Arlind Maloku, QE.*
- 19. Përfaqësues të medias. (Kameramanët prezent vetëm në prezantimin e rendit të ditës).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e programit të vlerësimeve etike dhe profesionale për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç ju kemi bërë me dije, Këshilli do zhvillojë mbledhjen e radhës të datës 10.12.2019. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët dhe siç ju kemi bërë me dije, në mbledhjen e radhës, sot janë 6 çështje për t’u diskutuar.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e programit të vlerësimeve etike dhe profesionale për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve lidhur me mbarimin e statusit të magistratëve, për shkak të dorëheqjes të disa gjyqtarëve.

Çështja e tretë ka të bëjë lidhur me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidaturat nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurat e komandimit”.

Çështja e pestë është shqyrtimi i projektvendimeve lidhur me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës, për magistrat, profili gjyqtar, konkretisht për kandidatët: znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Dhe çështja e fundit, jo më pak e rëndësishme, ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë të kandidatëve, znj. {...} dhe znj. {...}.

Për të kaluar më pas, nëse nuk kemi ndonjë kundërshtim dhe jemi dakord me rendin e ditës, atëherë unë i ftoj gazetarët të ulen, të jenë të pranishëm për të dëgjuar

diskutimet e Këshillit për shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës dhe kamerat të largohen nga ambientet e sallës.

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)

Pa vonesë kalojmë me relatimin e projekt-aktit të parë, i cili ka të bëjë me miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2020, projekt-akt i cili do të relatohet nga kryetarja e Komisionit.

Ah, do të relatohet nga zonja Brunilda Kadi, anëtare e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Brunilda Kadi: Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 85/1 të ligjit nr. 96, i ndryshuar, brenda muajit nëntor të çdo viti, duhet të miratojë programin me listën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit pasardhës, duke përcaktuar edhe periudhën e vlerësimit. Qëllimi i këtij programi është që të përgatitet një plan pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2020, por kjo nuk nënkupton fillimin e procesit të vlerësimit. Miratimi i këtij programi iu shërben gjithashtu kryetarëve dhe kancelarëve të gjykatave, që të organizojnë punën për plotësimin e tabelave statistikore dhe dërgimin e tyre në Këshill, brenda muajit janar, përpara se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar që përfshihet në këtë listë.

Me vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, Këshilli ka miratuar rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, dhe me vendimin tjetër nr. 264 ka miratuar metodologjinë e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit. Këto akte kanë hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 159.

Bazuar në ligjin për Statusin dhe dy vendimet e sipërcituara, Këshilli i Lartë Gjyqësor, harton këtë program për të gjithë gjyqtarët që të vlerësohen përgjatë vitit 2020.

Ky program vlerësimi përmban listën e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë këtij viti si dhe periudhën e vlerësimit përkatës.

Në lidhje me gjyqtarët që vlerësohen dhe periudhën e tyre të vlerësimit, ky program përmban:

1) Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë

nga organet e rivlerësimit, në vijim të procesit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përkon me periudhën 3-vjeçare të rivlerësimit kalimtar;

2) Vlerësimin normal të gjyqtarëve me jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale në datë 01.01.2017, për periudhën e vlerësimit 2017-2019;

3) Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-31.12.2019, sipas një programi të veçantë që Këshilli do të miratojë në rastet kur kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele.

Pjesë e këtij programi vlerësimi, nuk janë kryetarët e gjykatave, sepse aktualisht pjesa më e madhe e gjykatave drejtohen nga zëvendëskryetarët. Një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të gjykatave, siç jemi në dijeni, janë shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar dhe pjesa tjetër është në këtë proces. Veç kësaj rrethane, rregullat plotësuese të vlerësimit të veprimtarisë së kryetarëve nuk janë miratuar ende. Përcaktimi i listës me kryetarët e gjykatave që do të vlerësohen, mbetet një nga prioritetet e ardhshme të programit të vlerësimit.

Lista e gjyqtarëve që do të vlerësohen gjatë vitit 2020, është përpiluar mbi prioritetet e mëposhtme:

Së pari, bazuar në nenin 171/5 të ligjit për Statusin dhe neneve 21/1 dhe 23/a të vendimit 263, të sipërcituar në fillim janë përfshirë në listë, për të përcaktuar gradën/nivelin e vlerësimit përkatës, për periudhën e vlerësimit '13-'16, gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Kjo listë përmban gjyqtarët (...). E keni listën, siç ju është nisur paraprakisht, që është një listë me 15 gjyqtarë.

Këshilli do të përfshijë në këtë listë gjatë planifikimeve 3-mujore të fillimit të procesit të rivlerësimit, edhe gjyqtarët, të cilët gjatë vitit 2020, kalojnë me sukses këtë proces me vendim të formës së prerë. Që do të thotë që nuk është shteruese kjo tabela.

Në këtë listë Këshilli vlerëson të mos përfshijë:

a) Gjyqtarët të cilët janë anëtarë të tij, e konkretisht: gjyqtari Medi Bici, gjyqtari Ilir Toska, gjyqtarja Brikena Ukperaj, gjyqtari Dritan Hallunaj, gjyqtarja Marçela Shehu dhe gjyqtarja Brunilda Kadi. Arsyeja e mospërfshirjes së këtyre gjyqtarëve në këtë listë,

lidhet me faktin se vlerësimi i anëtarëve aktualë të Këshillit nga vetë ky Këshill, do t' i vendoste ata në një pozicion jo të përshtatshëm për sa i përket perceptimit të publikut dhe gjyqtarëve të tjerë.

b) Të mos përfshijë gjyqtarin Ardian Dvorani, anëtar i Gjykatës së Lartë. Arsyeja e mospërfshirjes së këtij në listë lidhet me faktin se gjatë periudhës së vlerësimit për të cilën bëhet gradimi (pra 2013-2016), anëtari i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë subjekt i vlerësimit etik dhe profesional. Legjislacioni i mëparshëm nuk parashikonte një vlerësim të tillë për anëtarët e Gjykatës së Lartë.

Së dyti, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, bazuar në nenin 84 dhe 175/1 (*lapsus, duhet 171/5*) të ligjit për Statusin dhe vendimet e Këshilli të sipërcituar 263, janë përfshirë në listën e gjyqtarëve që do të vlerësohen në vitin 2020, vetëm gjyqtarët që kanë pasur në datë 01 janar 2017, pra periudha kur fillon vlerësimi, jo më pak se 3 vjet dhe jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale.

Arsyeja e këtij kufizimi është e lidhur me përcaktimet e nenit 84, sipas të cilit: "...gjyqtarët vlerësohen një herë në 3 vjet, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të përvojës profesionale, përfshirë edhe përvojën profesionale si ndihmësmagjistrat ose magjistrat i komanduar, dhe një herë në 5 vjet, pas 15 viteve të para të përvojës profesionale si magjistrat".

Në kushtet kur periudha e vlerësimit që përmban ky program, është 3-vjeçare e kushtëzuar nga fakti që do fillojë në 1 janar 2017, për shkak se 3-vjeçari i mëparshëm përfshihet tek periudha e rivlerësimit, në këtë listë nuk mund të përfshihen gjyqtarët që kanë pasur mbi 15 vjet përvojë profesionale në datën 1 janar 2017, pasi për këta gjyqtarë periudha e vlerësimit është 5-vjeçare dhe vlerësimi i tyre fillon vetëm në vitin 2022.

Lista e dytë me këta gjyqtarë, që në numër në total është 106, siç e keni, s'po lexohet sepse e keni me shkrim dhe për efekt kohe s'ka kuptim.

Në listën e mësipërme nuk janë përfshirë gjyqtarët të cilët në 01 janar 2017 nuk kishin plotësuar 3 vite përvojë profesionale, -e sqaruar edhe më lart kjo, -sepse minimumi i periudhës së vlerësimit është 3 vjet. Do përfshihen në vitet pasardhëse kur të plotësojnë këtë kriter.

Në këtë listë nuk është përfshirë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë znj. {...}, e cila ushtron, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që nga data 05.10.2007, ushtron në fakt detyrën e gjyqtarit që nga ky vit. Me vendimin nr. 45, datë 22.09.2017 të ish-KLD, asaj i është dhënë leje prindërore e papaguar deri në datë 06.08.2020. Në këto kushte, bazuar në nenin 5, pika 4 të vendimit 263 të Këshillit, kjo gjyqtare nuk mund të vlerësohet për periudhën 01 janar 2017 - 31 dhjetor 2019, pasi gjatë kësaj periudhë ajo ka ushtruar detyrën për më pak se një vit.

Në lidhje me planifikimet 3-mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, siç është parashikuar në vendimin 263, në nenin 11, pika 1, është përcaktuar se: “Këshilli miraton brenda muajit nëntor, jo vetëm programin por edhe përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, planifikimet 3-mujore të vlerësimeve bëhen pjesë e programit të vlerësimit, për aq sa është e mundur. Duke marrë në konsideratë faktin që ky është programi i parë i vlerësimeve pas krijimit të këtij Këshilli, situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, vendet vakante që mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo transferim paralel, saktësimin e burimeve njerëzore që do të merren me këtë proces, etj., Këshilli vlerëson që planifikimet 3-mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Këshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar.

Ndërkohë, ky program përmban prioritete të planifikimeve 3-mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, duke ndjekur këtë radhë (që do të thotë, kur të bëhen planifikimet tremujore, do ndiqet ky lloj prioriteti që do lexohet më poshtë):

Së pari do bëhet gradimi i gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, sipas Listës I, bazuar kjo në nenin 23/a të vendimit nr. 263;

Së dyti, do kryhen me përparësi të gjitha vlerësimet sipas nenit 22 dhe 23/b të vendimit nr. 263; (dyshi ka të bëjë me vlerësimet njëvjeçare të detyrueshme kur ka kërkesë në lëvizje në detyrë ose lëvizje paralele)

Së treti, do jetë vlerësim normal për periudhën 01 janar 2017 – 31 dhjetor 2019 të të gjithë gjyqtarëve të Listës II, brenda së cilës do ketë një përparësi si më poshtë:

Së pari gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, sipas Listës I, por që kanë jo më shumë se 15 vjet përvojë profesionale deri në 01 janar 2017, -dhe kjo është e kuptueshme me shpjegimin që u dha pak më përpara sepse është vetëm periudhë trevjeçare vlerësimi. Pra, gjyqtarët që kanë kaluar me sukses vetingun (atë fjalën që përdorim në praktikë), përveç gradimit, do iu bëhet edhe vlerësimi normal me prioritet, sipas prioriteteve që u lexuan më lart.

Mbas këtyre, prioritet i dytë janë gjyqtarët të cilët kanë jo më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në 01 janar 2020 dhe që nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm. Kriteri për periudhën “mbi 7 vjet përvojë profesionale”, lidhet me kriterin e përvojës profesionale për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit. Ndërkohë kriteri “nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm” mundëson vënien, sa më shumë të jetë e mundur, në pozita të barabarta të të gjithë gjyqtarëve.

Në radhë të tretë do jenë gjyqtarët të cilët kanë jo më pak se 7 vjet përvojë në datën 01 janar 2020 dhe që kanë një vlerësim profesional të mëparshëm, me qëllim që këtyre gjyqtarëve t’iu mundësohet një vlerësim i dytë real dhe në kohë, -me të njëjtën logjikë dhe parim që u tha më lart;

Së katërti, do jenë gjyqtarët të cilët kanë më pak se 7 vjet përvojë gjyqtarët të cilët kanë më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 01 janar 2020 dhe që nuk kanë asnjë vlerësim;

Së pesti, do jenë pjesa tjetër që ngelet nga lista.

Miratimi i këtij programi për Këshillin, sidomos për Komisionin përgjegjës, mbart riskun e mospërfundimit brenda vitit 2020 të të gjitha vlerësimeve, sepse pavarësisht numrit të panjohur deri në këtë moment të gjyqtarëve që do të kandidojnë për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, në kushtet e ecures së procesit të rivlerësimit, nevojës për plotësimin e vendeve vakante nëpërmjet lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë dhe zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave, ka shumë mundësi dhe rritet numri i subjekteve të vlerësimit etiko-profesional. Gjithsesi, në eventualitetin e mospërfundimit të të gjitha

vlerësimeve brenda vitit '20, ato do të trajtohen me përparësi në vitin pasardhës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kadi!

Kemi ndonjë sugjerim ose ndonjë sqarim lidhur me projekt-aktin e relatuar?

Brunilda Kadi: Thjesht doja të sqaroja diçka.

Të gjithë anëtarëve iu janë nisur me e-mail të gjitha listat mbi të cilën është bazuar ky program, pra listën e të gjithë gjyqtarëve, të atyre që kanë kaluar vetingun për procesin e rivlerësimit me vendim të formës së prerë, ata që janë në proces; ata që pritet t'u marrë vendimi formë të prerë; gjyqtarët kur janë emëruar, lëvizjet e tyre si janë bërë ndër vite dhe statistikat me të gjithë vlerësimet, pra për secilin nga gjyqtarët që janë sot në sistem, sa vlerësime ka secili. Pra të gjitha ato që u lexuan në program, i kanë të mbështetura tek listat që u janë dërguar të gjithë anëtarëve.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, në qoftë se nuk kemi ndonjë diskutim apo sqarim në lidhje me përmbajtjen.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Desha të sqaroj që materialet kanë qenë të përgatitura nga Komisioni ynë përpara fundit të nëntorit, në mënyrë që në mbledhjen e fundit të atij muaji të miratojë programin, siç e parashikon edhe neni 85 i ligjit për Statusin. Për shkak të faktit të njohur botërisht tani të tërmetit të datës 26 nëntor, mbajtja e mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor u pamundësua, kështu që kjo është arsyeja pse programi sillet për miratim në mbledhjen e sotme. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

(Vota e zotit Bici nuk dëgjohet.)

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Miratimin e “Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 10.12.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve për mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, për disa gjyqtarë, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 7. Elisma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 15. Erion Fejzulla, USAID.*
- 16. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 17. Eris Milova, KSHH.*
- 18. Arlind Maloku, QE.*
- 19. Përfaqësues të medias. (Kameramanët prezent vetëm në prezantimin e rendit të ditës).*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve për mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, për disa gjyqtarë, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë.

Siç ju bëra dijëni, lidhur me projekt-aktin e dytë, kemi shqyrtimin e projektvendimeve për mbarimin e statusit të magjistratit për disa gjyqtarë.

Fillojmë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren {...}. Relatimi i projekt-aktit do bëhet nga zoti Toro, anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, më datën 27.11.2019 është depozituar një kërkesë me shkrim (protokolluar me nr.5890) nga gjyqtarja e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Sarandë, {...}, nëpërmjet të cilës ajo ka paraqitur dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit.

Në vështrim të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Në rastin konkret, dorëheqja e znj. {...} është bazuar në pikën 3, të nenit 65, të ligjit të Statusit.

Si motiv të dorëheqjes, znj. {...} ka parashtruar detyrimin për të shkuar pranë familjes e cila jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht e shoqëruar kjo me dokumentacionin përkatës të leje qëndrimit dhe prej disa vitesh ajo jeton atje me familjen, por ndërkohë janë verifikuar edhe disa probleme shëndetësore për djalin e saj i cili është diagnostikuar së fundi me “Costochondritis” (infeksion inflamator i brinjëve)

dhe në këtë kontekst kërkohet përkujdesje e veçantë për të. Dorëheqja sipas nenit 65 të ligjit të sipërcituar jep efekte në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes, domethënë më datë 31.12.2019.

Për rrjedhojë, znj. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 31.12.2019 duke e mbështetur këtë kërkim në diagnozën të cilën ne sapo e cituam, natyrisht që është e shoqëruar edhe me aktet të cilat ju jeni njohur nëpërmjet dërgimi tek-maili juaj.

Në lidhje me mos cenimin e interesit publik nga dhënia e efekteve të dorëheqjes përpara afatit ligjor, konstatohet se me cilësinë e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë znj. {...} deri më datë 05.12.2019 ka 171 çështje gjyqësore, ku përfshihen edhe 76 vendime gjyqësore të pazbardhura. Në konsideratë të këtij fakti si edhe për të evituar sjelljen e pasojave negative për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim si dhe për dhënien e drejtësisë do të propozonim mbarimin e statusit me 17 dhjetor 2019, kohë e mjaftueshme (në opinionin tonë) për të përmbushur detyrimet e ushtrimit të funksionit si gjyqtare.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtarës znj. {...}, duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit.

Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit.

Së dyti, kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtarja në fjalë ka parashtruar një motiv për dorëheqjen e saj, motiv ky që, është lidhur jo vetëm me faktin se familja e saj ndodhet me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por dhe me gjendjen shëndetësore dhe serioze në të cilën ndodhet djali i saj. Familja përben bërthamën e shoqërisë dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka kushtuar në nenin 53, 54 mbrojtje të veçantë. Më tej edhe manuali i pare i të drejtave të njeriut sanksionon se “Çdo njeri ka të drejtën për respekt për jetën e tij private dhe familjare, vendbanimin e tij dhe korrespondencën e tij. Një autoritet publik nuk ndërhyr ndaj ushtrimit të kësaj të drejte përveçse kur kjo është në përputhje me ligjin dhe kur është e nevojshme në një shoqëri

demokratike në interes të sigurimit kombëtar, sigurisë publike..., etj.”

Së treti, dhënia e efekteve të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit, si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtarës znj. {...} duhet të japë efektet, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtarës nga njëra anë, por edhe lënien e një kohe të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtarja mund të përfundojë gjykimin e atyre çështjeve që mund të jenë në fazën e fundit, por edhe për dorëzimin e detyrës nga ajo. Nga vlerësimi mbi këto kritere, data në të cilën do të krijojë efekte ky vendim, do të jetë data 17.12.2019 e cila duket që i konsideron të dyja shkaqet e sipërcituar.

Mbi sa më lart, KZHK i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të vendosë: Deklarimin e mbarimit të statusit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 17.12.2019.

Përfundimisht e menjëhershëm të znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Përfundimisht ky ishte edhe projekt-drafti i përgatitur në rastin e dorëheqjes së zonjës {...}, duke propozuar miratimin e tij.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro për relatimin e projekt-aktit.

Nëse keni ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit dhe shkaqet?
Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 17.12.2019. 3. Përrjashtimin e menjëhershëm të znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. 4. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit. –Jo, kjo nuk është?!

Okej! Atëherë, po e lexoj edhe një herë tjetër.

Pra - 3. Përrjashtimin e menjëhershëm të znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. 4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në relatimin e projekt-aktit tjetër që ka të bëjë edhe ky me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren {...}. Relatimi i këtij projekt-akti do bëhet nga zoti Ilir Toska, kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 04.12.2019, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, znj.{...}, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit.

Dorëheqja e zonjës {...} është bazuar në pikën 3 të nenit 65 të ligjit të Statusit, sipas të cilit: “3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Si motiv të dorëheqjes znj.{...} ka parashtruar angazhimin e saj në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor, konkretisht në pozicionin e juristes pranë Shoqërisë “{...}”, gjë për të cilën, mes saj dhe shoqërisë në fjalë, është lidhur dhe një kontratë individuale pune datë 04.12.2019, sipas aktit noterial të kësaj date bërë përpara noteres {...}, Tiranë, referuar të cilës kjo marrëdhënie juridike pune është përcaktuar të fillojë më datë 15.12.2019, pra përpara afatit kur dorëheqja e gjyqtarës jep efekt sipas ligjit, domethënë në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes, pra më datë 31.01.2020.

Për rrjedhojë, znj.{...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 15.12.2019, ditë kur ajo do të duhej të fillonte punë pranë Shoqërisë “{...}” sh.p.k.

Marrë shkas nga kërkesa e motivuar për dorëheqje nga statusi i magjistratit e znj.{...}, me qëllim për të vlerësuar moscenimin e interesit publik nga dhënia efekte të dorëheqjes përpara afatit ligjor, u kërkuar informacion nga gjykata ku znj.{...} ushtron detyrën e gjyqtarës, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Kjo e fundit, me shkresën e datës 06.12.2019, ka informuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se dhënia efekt nga Këshilli të dorëheqjes së gjyqtarës {...} përpara datës 31.01.2020, nuk cenonte veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe as

funksionalitetin e saj, si dhe të çështjeve në gjykim, e për rrjedhojë nuk cenonte interesin publik në kuptim të krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, kjo gjykatë ka aktualisht në ushtrim të funksionit 13 gjyqtarë, ndërkohë që gjyqtarja {...} ka në shqyrtim aktualisht si relatores/kryesues 5 çështje gjyqësore, nga të cilat në 2 çështje shqyrtimi gjyqësor është pezulluar. Përveç tyre, gjyqtarja në fjalë ka në shqyrtim edhe 4 kërkesa penale, ndërsa nuk ka në shqyrtim asnjë kërkesë në seancë paraprake apo në fazën e hetimit paraprak.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtarës znj. {...}, duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit. Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Së dyti, kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtarja në fjalë ka parashtruar një motiv për dorëheqjen e saj, motiv ky që, përveç se personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar. Së treti, dhënia e efekteve të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit, si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtarës znj. {...} duhet të japë efekt, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtarës nga njëra anë, por edhe lënien e një kohe të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtarja mund të përfundojë gjykimin e atyre çështjeve që mund të jenë në fazën e fundit, por edhe për dorëzimin e detyrës nga ajo. Nga vlerësimi mbi këto kritere, data 16 dhjetor duket që konsideron të dyja ato.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe të vendosë: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për shkak të

dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 16.12.2019. 3. Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Ky është propozimi i bërë nga Komisioni. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Jo!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 16.12.2019. 3. Përjashtimin e menjëhershëm të znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. 4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në projektvendimin tjetër, lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin {...}, projektvendimi i të cilit do relatohet nga zoti Ilir Toska, kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 04.12.2019, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, z.{...}, nëpërmjet të cilës ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit.

Dorëheqja e zotit {...} është bazuar në pikën 3 të nenit 65 të ligjit të Statusit.

Si motiv të dorëheqjes z.{...} ka parashtruar moshën, gjendjen shëndetësore, si dhe angazhimin e tij në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor. Konkretisht, referohet se z.{...} në janar 2020 mbush moshën 65 vjeç, ndërsa pas një vizite mjekësore të datës 10 tetor 2019, nga një mjek neurolog në Janinë, Greqi, sipas vërtetimit mjekësor datë 11 nëntor 2019 (në gjuhën greke dhe i përkthyer në shqip), është diagnostikuar me një sëmundje neurologjike. Nga një recetë mjekësore e mëvonshme, e datës 29 nëntor 2019, duket që z.{...} vijon terapinë mjekësore. Me tej, nga z.{...} referohet angazhimi i pritshëm i tij në pozicionin e juristit pranë Shoqërisë “{...}” sh.p.k. dhe Shoqërisë “{...}” sh.p.k., gjë për të cilën, mes tij dhe shoqërive në fjalë, është lidhur dhe një Akt-Marrëveshje datë 27.11.2019, sipas të cilës kjo marrëdhënie juridike pune është përcaktuar të fillojë më datë 15 dhjetor 2019, pra përpara afatit kur dorëheqja e gjyqtarit jep efekt sipas ligjit, domethënë në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes, pra më datë 31 janar 2020.

Për rrjedhojë, z.{...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 15 dhjetor 2019, ditë kur ai do të duhej të fillonte punë pranë Shoqërisë “{...}” dhe Shoqërisë “{...}”.

Marrë shkas nga kërkesa e motivuar për dorëheqje nga statusi i magjistratit e z.{...}, me qëllim për të vlerësuar moscenimin e interesit publik nga dhënia efekte të dorëheqjes përpara afatit ligjor, u kërkua informacion nga gjykata ku z.{...} ushtron

detyrën e gjyqtarit, Gjykata e Apelit Gjirokastër. Kjo e fundit, me shkresën e datës 06 dhjetor 2019, ka informuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se dhënia efekt nga Këshilli të dorëheqjes së gjyqtarit {...} përpara datës 31 janar 2020, mund të cenonte interesin publik në kuptim të krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë sa i përkiste gjykimit të dy çështjeve civile, konkretisht në:

- një çështje me objekt “Shpërblim dëmi jopasuror”, e cila ndodhej në fazën e konkluzioneve përfundimtare dhe seanca ishte caktuar më datë 16 dhjetor 2019;

- një çështje me objekt “Sigurim padie”, e cila ishte planifikuar për t’u shqyrtuar më datë 10 dhjetor 2019.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, gjyqtari {...}, përveç dy çështjeve si më lart, kishte në shqyrtim aktualisht si relator edhe 53 çështje (1 nga të cilat është çështje penale), nga të cilat në 15 çështje ishte riçelur shqyrtimi gjyqësor, kurse në çështjet e tjera shqyrtimi gjyqësor ende nuk kishte filluar. Po ashtu, sipas informacionit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, gjyqtari {...} ishte anëtar i trupit gjykues edhe në disa çështje të tjera të kësaj gjykate, por se, në këto raste, për shkak të largimit të tij, trupi gjykues mund të plotësohej me gjyqtarë të tjerë të kësaj gjykate.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtarit z. {...}, duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit. Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Së dyti, kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtari në fjalë ka parashtruar motiv për dorëheqjen e tij, motiv ky që, përveç se personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar. Së treti, dhënia efekte të dorëheqjes së gjyqtarit përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtarit z. {...} duhet të japë efekt, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtarit nga njëra anë, por edhe lënien e një kohe të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtari mund të përfundojë gjykimin e

atyre çështjeve që janë në fazën e fundit të gjykimit, por edhe për dorëzimin e detyrës nga ai. Nga vlerësimi mbi këto kritere, data 20 dhjetor 2019 duket që konsideron të dyja ato.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e z. {...} dhe të vendosë deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për shkak të dorëheqjes së motivuar të tij nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 20.12.2019. Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Ky është edhe propozimi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 20.12.2019. 3. Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. 4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit

nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 10.12.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 11. Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 15. Erion Fejzulla, USAID.**
- 16. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 17. Eris Milova, KSHH.**
- 18. Arlind Maloku, QE.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër sipas rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe që do relatohet nga zoti Erjon Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Që prej themelimit të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në detyrimet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe në standardet e praktikave më të mira për administrimin e sistemit gjyqësor, të promovimit dhe mbrojtjes së imazhit të një drejtësie të pavarur dhe të paanshme, cilësore dhe efçente, është angazhuar për vendosjen e marrëdhënieve të mira me mediat, duke marrë masat për të lehtësuar realizimin e misionit të tyre sa më mirë.

Liria e fjalës, liria e informimit dhe e kritikës, liria e shtypit, si dhe aksesit në dokumentet zyrtare, janë elementë bazë të një shoqërie demokratike. Në këtë drejtim, Këshilli i Lartë Gjyqësor mban në konsideratë se komunikimi me mediat si një institucion social, për të qenë efektiv dhe në shërbim të drejtësisë, si komponent thelbësor për një shoqëri të lirë dhe demokratike, duhet të jetë sa më i përgjegjshëm dhe profesional. Këshilli i Lartë Gjyqësor njeh dhe kontribuon në lirinë e dhënies së informacionit të hapur dhe transparent për publikun, të shprehjes së lirë të mendimit dhe opinionëve, si themeli esencial i një shoqërie të hapur dhe demokratike, duke inkurajuar edhe formimin dhe shprehjen e mendimit të lirë kritik për vetë funksionimin e Këshillit dhe të sistemit gjyqësor në tërësi. Në këndvështrimin e këtij Këshilli, liria e informimit nuk është vetëm një e drejtë, por edhe një qëllim social me objektiva të shumfishta, raportues, pasqyrues, edukues, për të garantuar pjesëmarrjen efektive demokratike, që nënkupton edhe përgjegjësi.

Dhënia e drejtësisë mund të jetë e panjohur dhe e pakuptueshme për një pjesë të popullsisë, si për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit të organeve gjyqësore, ashtu edhe sa i përket kufizimeve ligjore për bërjen publike të përmbajtjes së vendimeve gjyqësore. Do citoj Opinionin nr.7 të Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (siç njihet ndryshe me akronimin CEPEJ), i cili është shprehur se: “Gjykatat janë në fakt, dhe publiku i pranon si të tillë, si vendi i duhur ku afirmohen të drejtat e detyrimit e tij ligjore dhe vendi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Pjesa më e madhe e publikut i respekton gjykatat dhe beson në aftësitë e gjyqtarëve për ushtrimin e detyrës prej tyre. Megjithatë, të kuptuarit e rolit të dhënies së drejtësisë në një demokraci është shumë i rëndësishëm, në veçanti të faktit që detyra e gjyqtarit është të zbatojë ligjin me drejtësi dhe paanshmëri, pa marrë parasysh presionet e mundshme sociale apo politike...”

Në ditët e sotme të komunikimit të vazhdueshëm, gjyqtarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për faktin që për shkak të rëndësisë së detyrës që ushtrojnë, veprimet dhe vendimet e tyre tërheqin vëmendjen e veçantë të medias dhe të publikut. Kështu që gjithmonë e më tepër merr rëndësi komunikimi me publikun, së bashku me aftësimin për të përballuar sfidat e realizimit të një komunikimi etik, transparent dhe profesional. Në funksion të ruajtjes dhe forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, në çdo kohë gjykatat duhet të kenë një qasje profesionale dhe etike në komunikimin me publikun, e për këtë qëllim, merr rëndësi të veçantë caktimi i gjyqtarëve për mediat, për çdo juridiksion apeli.

Gjyqtarët për mediat do të ushtrojnë detyrat në funksion të rritjes së transparencës në veprimtarinë gjyqësore, si një element i rëndësishëm për shtetin e së drejtës dhe një garanci më tepër për një gjykim të drejtë. Drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe të shihet që bëhet, dhe për këtë, transparenca, në mënyrë të veçantë karshi medias, është thelbësore. Nëpërmjet transparencës dhe informimit të publikut, gjyqësori do të mund të evidentojë vlerat e gjyqtarëve, të lehtësojë ndërveprimin me publikun dhe të forcojë besimin e publikut në të, si mbrojtës i interesit publik dhe i të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Ka ardhur koha që gjyqësori të pranojë rolin e medias, e cila ndër të tjera, luan

edhe rolin e pjesës vigjilente të publikut, për të nxjerrë në pah të metat dhe mangësitë në funksionimin e tij, duke ndihmuar në mënyrë konstruktive për përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së gjyqësorit dhe të cilësisë së shërbimeve që i ofrohen publikut.

Bazuar në sa më sipër, në zbatim të nenit 91, pika 3 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për caktimin e një gjyqtari për mediat për çdo juridiksion apeli, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon Mbledhjes Plenare caktimin në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat, gjyqtarët e mëposhtëm: Vojsava Osmanaj, për juridiksionin e Apelit Shkodër; Edlira Petri, për juridiksionin e Apelit Tiranë; Desart Avdulaj, për juridiksionin e Apelit Durrës; Klodiana Gjyzari, për juridiksionin e Apelit Vlorë; Etleva Temo, për juridiksionin e Apelit Korçë; Enton Dhimitri, për juridiksionin e Apelit Gjirokastrë; Lindita Sinanaj, për juridiksionin e Apelit Administrativ dhe; Saida Dollani, për juridiksionin e Apelit për Krime të Rënda (që së shpejti do të shndërrohet në Gjykatën për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit).

Ky propozim mbështetet në përvojën profesionale të tyre si gjyqtarë, trajnimet e tyre në kuadër të trajnimit vazhdueshëm, angazhimet e tyre të gjera profesionale në fusha të ndryshme të së drejtës, bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm me Shkollën e Magjistraturës, si edhe faktin që gëzojnë reputacion të mirë dhe besimin e kolegëve, si garanci për përçimin te media dhe publiku të vlerave më pozitive dhe komunikimin me ta në mënyrë profesionale e transparente. Ishin këta gjyqtarë që pikërisht iu përgjigjën thirrjes së Këshillit për të shprehur interesin e tyre për të marrë secili përcaktimin në pozicionin e Gjyqtarit për Median.

Gjyqtarët e Medias, në bashkëpunim me Këshillat e Gjykatave dhe shërbimet për marrëdhëniet me publikun do të kujdesen që gjykatat në juridiksionin e tyre të garantojnë informimin e publikut dhe të medias, në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga ky Këshill, me qëllim që t’i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e ndonjë gabimi të mundshëm mbi faktet për çështje të caktuara, t’i

komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik, të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik, të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore, të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin. Gjithashtu, Gjyqtarët e Medias do të kujdesen që gjykatat në juridiksionin e tyre të garantojnë informimin e publikut dhe të medias nëpërmjet portaleve të tyre në internet për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjykatave, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, informacion për çështje të veçanta gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifatat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, apo çështje të tjera me interes për publikun.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në veçanti unë në cilësinë e anëtarit të caktuar për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, do të bashkëpunojë ngushtësisht me Gjyqtarët e Medias për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, si edhe do të bashkëpunojë me Shkollën e Magjistraturës, si institucioni i ngarkuar nga ligji për ofrimin e trajnimeve për vetë ne si anëtarë të Këshillit, Gjyqtarët për Mediat, për administratën e Këshillit si dhe për nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun, me synim rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj!

Atëherë, nëse kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin paraprakisht?

Kalojmë në votimin e tij, sipas propozimit të bërë nga relatori përkatës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat, për çdo juridiksion apeli: znj. Vojsava Osmanaj, juridiksioni i Apelit Shkodër; znj. Edlira Petri, juridiksioni i Apelit Tiranë; z. Desart Avdulaj, juridiksioni i Apelit Durrës; znj. Klodiana Gjyzari, juridiksioni i Apelit Vlorë; znj. Etleva Temo, juridiksioni i Apelit Korçë; z. Enton Dhimitri, juridiksioni i Apelit Gjirokastrë; znj. Lindita Sinanaj, juridiksioni i Apelit Administrativ dhe; znj. Saida Dollani, juridiksioni i Apelit për Krime të Rënda/për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. 2. Gjyqtari për Mediat përfiton një trajtim financiar 5%, shtesë page, mbi pagën bruto fillestare të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 10.12.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
- 6. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 7. Elisma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 11. Mirjon Brahimllari, Këshilltar i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 12. Anisa Kuqi, EURALIUS.**
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**
- 14. Klodian Rado, EURALIUS.**
- 15. Erion Fejzulla, USAID.**
- 16. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 17. Eris Milova, KSHH.**
- 18. Arlind Maloku, QE.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurat e komandimit”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës dhe që do relatohet nga kryetari i Komisionit, z. Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në kërkesën e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë ka përpiluar një projektvendim “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” dhe në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin , si dhe çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu në dispozitat e këtij ligji, konkretisht në nenet 54, 57 dhe 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjek Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet, në

këto raste.

Në lidhje me rastin në shqyrtim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është regjistruar shkresa e datës 30 shtator 2019, e Ministrisë së Drejtësisë, përmes të cilës Këshillit i është kërkuar komandimi i dy magjistratëve gjyqtarë në dy pozicione vakante të shërbimit civil pranë kësaj ministrie.

Në rrethanat kur Ministria e Drejtësisë në kërkesën e saj nuk kishte përcaktuar periudhën për të cilën kërkohej komandimi i dy magjistratëve, si dhe kriteret specifike të pozicioneve të punës në të cilat do të komandoheshin/kriteret që magjistratët duhet të përmbushin, me shkresën e datës 3 tetor 2019, Këshilli i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë plotësimin e kërkesës edhe me periudhën për të cilën kërkohej komandimi i dy magjistratëve dhe kriteret specifike të pozicioneve të punës për të cilat dy magjistratët do të komandoheshin apo kriteret që ata duhet të përmbushin.

Ministria e Drejtësisë, me shkresën e datës 11 tetor 2019, përcolli pranë Këshillit informacionin e nevojshëm për fillimin e procedurës së komandimit të kërkuar, duke përcaktuar 5 vjet periudhën për të cilën kërkohej komandimi, si dhe duke përcaktuar dhe kriteret specifike të pozicioneve të punës për të cilat kërkohej komandimi i dy magjistratëve.

Gjithashtu, shkresës së saj, Ministria e Drejtësisë i ka bashkëlidhur edhe formularët e përshkrimit të punës.

Marrë shkas nga kriteret specifike të pozicioneve të punës për të cilat kërkohej komandimi i dy magjistratëve, të cilat nuk merrnin tërësisht në konsideratë faktin që shpallja iu drejtohej magjistratëve gjyqtarë, Këshilli i Lartë Gjyqësor i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë, në rrugë elektronike, të konfirmonte kriteret e përcaktuara.

Ministria e Drejtësisë, me shkresën e datës 8 nëntor 2019, ka përcjellë pranë Këshillit kriteret e rishikuara specifike të pozicioneve të punës për të cilat kërkohej komandimi i dy magjistratëve. Kjo shkresë në fa fakt është protokolluar pranë Këshillit vetëm në datë 6 dhjetor 2019.

Kërkesat, sipas institucionit kërkues janë si vijon:

Për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë

së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, kërkohet që kandidati:

- a) Të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- b) Të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 5 vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;
- c) Të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;
- ç) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) Të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;
- dh) Të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

Ndërsa për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë të njëjtat kritere, me përjashtim të kriterit të përvojës, ku në rastin e përgjegjësit kërkohet 3 vjet.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 86, shkronja “d”, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshilli të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe të pozicionit “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë.

Me anë të këtij vendimi, rregullohet shpallja e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e dy pozicioneve si më lart, si kundër edhe kohëzgjatja e shpalljes, kriteret e vendosura dhe procedura e komandimit në atë pozicion.

Kreu I i projektvendimit, pika 1, bën fjalë për shpalljen e kërkesës për kandidatura, duke u përcaktuar se kërkesa shpallet për plotësimin e 2 pozicioneve të përmendura më lart.

Në pikën 2 të këtij Kreu, parashikohet afati i paraqitjes së kërkesave, që përcaktohet jetë dy javë nga shpallja e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 3 të këtij Kreu, përcaktohen dokumentet që duhet të paraqesë kandidati, konkretisht: kërkesë për komandim; jetëshkrim; diplomë për fitimin e titullit magjistrat, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës; dokument që vërteton përvojën në hartimin e akteve; certifikatë/dëshmi për zotërim gjuhe të huaj; rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup; certifikatë/dëshmi për njohjen dhe përdorimin e programeve kompjuterike bazë, si dhe çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

Në Kreun e II të projektvendimit, përcaktohet kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit të gjyqtarit.

Konkretisht, sipas pikës 1 të këtij Kreu, kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, përcaktohet të jetë deri në 5 vjet, pra sipas afatit të kërkuar nga institucioni kërkuar, Ministria e Drejtësisë, afat ky që është brenda limitit maksimal të përcaktuar nga ligji, pika 5, e nenit 53, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 2 të këtij Kreu, përcaktohen rastet e përfundimit të komandimit përpara afatit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, konkretisht kur: a) kërkohet nga vetë gjyqtari për shkaqe të justifikuara (përderisa komandimi bëhet vetëm me pëlqim), si dhe kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit, pra kur verifikohet kushti kryesor i komandimit.

Më tej, në pikën 3 të këtij Kreu, jepen kushtet e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, të përcaktuara nga neni 53 e vijues të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht: a) komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së

mëparshme të komandimit dhe d) kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

Në vijim, në pikën 4 të Kreut II, jepen kriteret e komandimit për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, sikurse ato janë përcaktuar në kërkesën e institucionit kërkues.

Ndërsa në pikën 5 të Kreut II, jepen kriteret e komandimit për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Në pikën 6 të këtij Kreu, përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve dhe kriterëve të kandidimit, konkretisht parashikohet që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 7 të Kreut II, përcaktohet procedura që do ndiqet, nga i Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për vlerësimin e plotësimit të kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 8 të këtij Kreu, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë Ministrisë së Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në dy pozicionet e përmendura më lart.

Në pikën 10 të këtij Kreu, parashikohet se, brenda dy javëve nga marrja e kërkesës nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin, në pozicionet respektive, të secilit kandidat të përzgjedhur nga Ministria e Drejtësisë.

Ndërkohë në pikën e fundit të Kreut II rregullohet situata ligjore kur asnjë prej

kandidatëve nuk plotëson kushtet ose kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Ministria e Drejtësisë. Në këtë rast, pas njoftimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe mbi kërkesën e saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e dy pozicioneve të përmendura më lart.

Së fundi, parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Po! Faleminderit!

Atëherë, nga përmbajtja e projektvendimit që keni sjellë propozim, nuk shikoj një mundësi ose si e mendoni juve, mundet që ne të revokojmë komandimin në një situatë - le të themi, të gjithë jemi koshient që situata e sistemit është e jashtëzakonshme dhe ndoshta, duhet ta nisja pyetjen: -Fillimisht, është bërë një parashikim ku jemi dhe nga mund të presim, nga cila gjykatë mund të presim që të ketë kërkesa që ne mund të kemi një vendimmarrje pozitive, pra që nuk do cenohet puna në gjykatë dhe të lejojmë komandimin (kuptohe, nëse plotësohet kushtet dhe kriteret për kërkuesit), -së pari. Pra, a ekziston potencialisht një gjykatë e tillë që mund të ketë një kandidat? Dhe së dyti, nëse situata do vazhdojë të përkeqësohet, kemi mundësi që ne të revokojmë, të ndërpresim komandimin? Dhe e treta që ka lidhje ndoshta më tepër me Komisionin ku unë bëj pjesë. Siç e dini të gjithë ne mund të kemi nevojë imediate për të bërë komandime të gjyqtarëve në Këshill për të ndihmuar në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, të cilët të gjithë biem dakord, që duhet të jenë sa më shumë të tillë, atëherë, mund të rriskojmë ne që të lejojmë komandimin tek Ministria e Drejtësisë në një pozicion që ndoshta, se të gjithë jemi për të mirën e përgjithshme, por ndoshta në pozicionin që kërkon Ministria, mund të gjenden persona të tjerë kompetent dhe ta bëjnë atë detyrë, ndërkohë që ne si Këshill do kemi nevojë më të domosdoshme për të pasur gjyqtarë të komanduar. A e kemi këtë mundësi ne në sistem sot? Duke menduar që situata sipas

gjasave do përkeqësohet sepse e shikojmë nga statistikat e procesit të rivlerësimit.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, për pyetjen e parë, nëse kemi bërë ndonjë studim për pritshmëritë se nga mund të vijnë kandidatët, - ne nuk kemi bërë ndonjë studim të tillë.

Brunilda Kadi: Jo, më fal. Më fal, Ilir Toska:. Një sekondë.

Jo nga mund të vijnë. Pra, cila do ishte një gjykatë që nuk do cenonte, në hipotezën që mund të ketë gjyqtarë nga ajo gjykatë dhe nuk do cenonte teorikisht funksionimin e asaj gjykate. A kemi ne sot të identifikuar një gjykatë të tillë? Se ne nuk mund ta parashikojmë nga do vijnë kandidatët. Thjesht, nëse nuk ka mundësi potenciale, për çfarë po e shpallim?! Kjo ishte ideja e pyetjes.

Ilir Toska: Atëherë, nuk mund ta paragjykoj se kush mund të jetë gjykata që nga mund të vijnë kandidaturat, nuk mund të parashikoj as nëse do të jetë ajo gjykatë që mund të vijë kandidatura, gjykatë që mund të cenohet funksionaliteti. Kemi konsideruar, sa kohë ligji nuk na jep kompetencë ta refuzojmë kërkesën që në fillim të herës, që të procedojmë duke e shpallur kërkesën dhe në çdo rast, në varësi të kandidatit që mund të paraqitet, të konsiderojmë cenimin e funksionalitetit të gjykatës. Kaq na thotë ligji. Nuk na thotë që ne të vlerësojmë një herë paraprakisht nëse do mund kërkesa të konsiderohet të plotësohet apo jo. Këshillit i është dhënë detyrimi që të procedojë me kërkesën dhe në varësi të kandidaturave që mund të paraqiten, të vlerësojë cenimet e funksionalitetit në gjykatat ku kandidati ushtron funksionin.

Çështje tjetër e dytë kush ishte?

Brunilda Kadi: A është e revokueshme?

Ilir Toska: Patjetër! E kemi konsideruar që ta revokojmë. Është e parashikuar edhe në projektvendim. Bëhet e ditur.

Mund ta lexoni projektvendimin. Janë kushtet që mund të revokohet vendimi kur cenohet funksionaliteti.

Pesa (5-sa) janë kushtet e komandimit.

Kushtet e komandimit janë: ...

Doni të shtoni ndonjë pikë tjetër?

Brunilda Kadi: Nuk thuhet!

Ilir Toska: Treshi, kushtet e komandimit.

Brunilda Kadi: Jo pra.

Pyetje ime ishte: E lejon. Komandohet.

Se atë e lexova unë, që mund ta refuzosh që në fillim.

Pyetja ime është: Nëse ti e lejon. Komandohet, dhe situata përkeqësohet. Ti ke mundësi si Këshill ta ndërpresësh komandimin? Për një situatë më të vështirë, -kjo ishte ideja.

Ilir Toska: Po lexoj pikën 2 të Kreut II.

“2. Kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, mund të përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.”

Besoj përmbush atë shqetësimin.

...kandidati... që mund t’i ndërpritet para afatit.

Naureda Llagami: Nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në vendimmarrje, në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë për:

a) Pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit;

b) Pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është dy javë nga dita e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kandidati për secilin nga dy pozicionet, duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim ku të specifikohet pozicioni ku kërkon të komandohet;

b) Jetëshkrim, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;

c) Diplomë për fitimin e titulli magjistrat, lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës;

ç) Dokument që vërteton përvojën në hartimin e akteve;

d) Certifikatë/Dëshmi për zotërim gjuhe të huaj;

e) Rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;

ë) Certifikatë/Dëshmi për njohjen dhe përdorimin e programeve kompjuterike bazë;

f) Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

I. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

1. Kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, është deri në 5 (pesë) vjet.

2. Kohëzgjatja e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, mund të

përfundojë para afatit:

a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;

b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

3. Kushtet e komandimit, në secilin nga dy pozicionet e shpallura, janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;

d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

4. Kriteret e komandimit për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë:

a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;

b) kandidati duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 5 vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;

c) kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;

ç) kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

d) kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;

dh) kandidati duhet të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

5. Kriteret e komandimit për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, janë:

a) kandidati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;

b) kandidati duhet të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit për të paktën 3 (tre) vjet, duke u vlerësuar pozitivisht pasja përvojë në hartim aktesh, si dhe në pozicione drejtuese;

- c) kandidati duhet të zotërojë një gjuhë të huaj, preferohet anglisht;
- ç) kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;
- dh) kandidati duhet të ketë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit.

6. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

7. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione të miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë Ministrisë së Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

9. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendos për komandimin, në pozicionet respektive, të secilit kandidat të përzgjedhur nga Ministria e Drejtësisë.

10. Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet dhe/ose kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Ministria e Drejtësisë, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë

Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit dhe të pozicionit “Përgjegjës i Sektorit të Hartimit të Akteve”, në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 10.12.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët: znj. {...}, Relator z. Ilir Toska; z. {...}, Relatore znj. Marçela Shehu; z. {...}, Relatore znj. Marçela Shehu; znj. {...}, Relator z. Alban Toro.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 15:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët: znj. {...}, Relator z. Ilir Toska; z. {...}, Relatore znj. Marçela Shehu; z. {...}, Relatore znj. Marçela Shehu; znj. {...}, Relator z. Alban Toro.

Naureda Llagami: Atëherë, para se të kalojmë në shqyrtimin e projekt-akteve të tjera, i ftoj të gjithë të pranishmit të largohen nga salla plenare, pasi diskutimi i tyre përmban informacione të klasifikuara dhe personat që nuk kanë certifikatën, nuk mund të jenë pjesë e dëgjësës së këtyre diskutimeve.

(Bëhet fjalë për pikën 5 në rendin e ditës: Shqyrtimi i projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët: znj. {...}, Relator z. Ilir Toska; z. {...}, Relatore znj. Marçela Shehu; z. {...}, Relatore znj. Marçela Shehu; znj. {...}, Relator z. Alban Toro.)

(Anëtarët bëjnë një pauzë të shkurtër.)

Në vijim të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët: znj. {...}, z. {...}; z. {...} dhe znj. {...}.

Propozoj që lidhur me trajtimin e këtyre 4 kandidatëve në mbledhje, procesverbali të mbahet me shkrim dhe jo me audio. Të mbahet me shkrim nga Rosalba Xhabrahimi. Jeni dakord me këtë propozim? E cila disponon Certifikatë Sigurie.

Atëherë, jemi dakord që për 4 kandidatët të mbahet procesverbali me shkrim nga

punonjësja që ka Certifikatë Sigurie?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

(Kjo pikë e rendit të ditës përmban informacione të klasifikuara dhe procesverbalet mbahen me shkrim dore dhe jo bazuar në regjistrimin audio.)

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor